VENDIM
Nr. 171, datë 28.6.2022

MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT, QË KONTROLLON INTERESAT E SHOQËRISË "M.T.C. ENERGY" SHPK

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 5, nenit 7 dhe nenit 9, pikat 4 dhe 5, dhe 8, si dhe nenit 10 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit, si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.6.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 935/6 prot., datë 23.6.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë M.T.C. Energy sh.p.k.",

konstatoi se:

- Shoqëria "M.T.C. Energy" sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 20, datë 21.3.2014, për një afat 30-vjeçar.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 646 prot., datë 6.5.2022, shoqëria ka paraqitur aplikimin për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e kësaj shoqërie, nëpërmjet shitjes së 80% të kuotave të zotëruara nga "Radove Energy Capital LTD", te "Hydrogy Holdings Single Member" S.A.
- Pas shqyrtimit paraprak të kërkesës dhe dokumentacionit bashkëlidhur, rezultoi se dokumentacioni nuk ishte i plotë dhe po ashtu kishte nevojë për të sqaruar më tej një pjesë të dokumentacionit të këtij aplikimi, ndaj në datën 7.6.2022, u zhvillua një seancë dëgjimore me shoqërinë, në vijim të së cilës, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 646/5 prot., datë 7.6.2022, shoqëria ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar.
- Nga analiza që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria "M.T.C Energy" sh.p.k. rezulton se ajo ka plotësuar tërësisht kërkesat e "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021.
- Shoqëria "M.T.C. Energy" sh.p.k. nuk ka detyrime të pashlyera ndaj ERE-s për sa i përket pagesave të rregullimit.
- Në vijim të dhënies së autorizimit, në zbatim të pikës 8 të nenit 9 të "Rregullores, shoqëria duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar të QKB-së", brenda 10 (dhjetë) ditëve nga reflektimi i këtij transferimi në të.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë "M.T.C Energy" sh.p.k.
2. Ortaku kryesor i shoqërisë "M.T.C. Energy" sh.p.k., me 80% të kuotave të kapitalit, bëhet shoqëria "Hydrogy Holdings Single Member" S.A.
3. Shoqëria "M.T.C Energy" sh.p.k. të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar të QKB-së, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga reflektimi i këtij transferimi në të.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti